

**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA**  
**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**OSNOVNI SUD PRISHTINA – BASIC COURT OF PRISTINA**

---

**PKR.nr.418/14**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Krime të rëndatrupit** gjykues në përbërje nga Shadije Gërguri si kryetare e trupit gjykues dhe gjyqtarëve Beqir Kalludra dhe Shashivar Hoti anëtarë të trupit, me bashkëpunëtorin profesional Driton Berisha, në lëndën penale kundër të akuzuarëve B.H.për shkak të veprës penale Vrasje në tentativë nga neni 178, lidhur me nenin 28 të KPK-së, R.2 Halilaj për shkak të veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPK-së, dhe G.M.për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Krimeve te Rënda-PP.nr.699/2014 të datës 30.07.2014, pas mbajtës së shqyrtimit gjyqësor publik, në prezencën e prokurorit të shtetit Armend Hamiti, të akuzuarve B.H. me mbrojtësin av.M.H. sipas autorizimit, R.H. me mbrojtësen av.E.V. - Sh. sipas detyrës zyrtare, dhe G.M., me dt: 16.07.2018, morri dhe publikisht shpallë:

**AKTGJYKIM**

**B.H.**, nga i ati I., e ëma S., e vajzërisë I., i lindur me dt. ... në f.sh.”M.1”, KK-P.1, ku dhe tani jeton, ka të kryer shkollën fillore, i martuar, baba i ... fëmiu, jo i punësuar, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr. Personal: 1231898197, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**R.H.**, nga i ati R.1, e ëma H.1, e gjinisë J., i lindur me dt. ..., në f.sh.”M.1”, KK-P.1, tani me vendbanim në fshatin “M.2” KK-P., ka të kryer 4 vjeçarën të shkollës fillore, i ve, baba i ... fëmiu, bujk, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr. Personal: ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**JANË FAJTOR**

**I akuzuari B.H.**

SEPSE: me datë 02.07.2014, rreth orës 22:15, në rr. “H.T.” në P.2, i pandehuri B.1 për shkak të raporteve të përkëqesuara në mes të axhës së tij të pandehurit R.2 në njërën anë me të dëmtuarin G. dhe B.M. në anën tjetër, duke e ditë se axha i tij, i pandehuri R.2 të njëjtën ditë rreth orës 16:00 h, ka pas mosmarrëveshje me të dëmtuarit, në momentin që e ka vërejtë duke ecur rrugës të

dëmtuarin G., fillimisht ka ndalur makinën, e më pas ka rritë shpejtësinë dhe me dashje që ta privojë nga jeta, me veturën e markës “Golf II”, ngjyrë e kuqe, e ka goditë të njejtin në trup duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore në regjionin e gjoksit, regjionin ijorokerbishtorë, në regjionin e gjunjëve, kërcinjëve dhe regjionin e nyjeve talokrulare të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbretës, e më pas është larguar nga vendi i ngjarjes,-

- me çka ka kryer veprën penale: Vrasje në tentativë nga neni 178, lidhur me nenin 28 të KPK-së

### **I akuzuari R.H.**

SEPSE: me datën: 02.07.2014, rreth orës 16:00 h, në mes fshatrave “M.1” dhe “T.”, Komuna e P.1, i pandehuri e ka përdorë në mënyrë frikësuese dhe kërcënuese pushkën automatike kallashnikov, të markës “AK-47”, të cilën paraprakisht e ka mbajtur në pronësi dhe pa autorizim, në atë mënyrë që deri sa i dëmtuari G. së bashku me djalin e tij B.2, djalin e vëllaut Z.1 dhe punëtorin A.M., kanë qenë duke prerë dru në vendin e quajtur “B.3”, i’u është afër atyre me armë në dorë, ku fillimisht i ka fyer me fjalë banale duke i’u drejtuar me fjalët ‘Pse po preni dru në këtë vend’, më pas a ke drejtuar armën nga ata dhe deri sa ka qenë duke u fjalosur, i dëmtuari G., ka shfrytëzuar rastin dhe nga mbrapa ia ka bllokuar duart, ndërsa i dëmtuari Bekim ka arrit që t’ia heq armën nga dora të cilën zyrtarët policorë së bashku me 28 copë fishek e kanë sekuestruar në shtëpinë e të dëmtuarit,-

- me çka ka kryer veprën penale: Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPK-së

Andaj gjykata në kuptim të neneve 2,3,7,8,17,28,41,43,45,73,75, 76,83 të KPRK-së, 365,363, 450, 454 dhe 463 të KPPK-s i:

## **GJYKON**

Të akuzuarit B.H.i shqipton **DENIM ME BURGIM** në kohëzgjatje prej 1 (një) **viti e 10 (dhjetë)** muaj.

Të akuzuarit R.H. i shqipton **DENIM ME BURGIM**, në kohëzgjatje prej **4 (katër) muaj**, në të cilin dënim i llogaritet koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data: 03.07.2014, deri me dt: 22.10.2014

Konform nenit 62 par.2 nën.par.2.7 të KPK-së, konfisohej arma e zjarrit AK 47 e shkurtër, një (1) karikator, 28 (njëzet e tetë) fishek të kalibrit 7.62 mm, dhe të njejtat asgjësohen pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit,

Të dëmtuarit G.M.dhe B.M.për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike, udhëzohen në kontest civil.

Të akuzuarit B.H.dhe R.H., obligohet të paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë të kësaj gjykate, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 100 € (njëqind) Euro, secili veç e veç, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi

**Kundër të akuzuarit:**

**G.M.**, nga i ati Z.2, e ëma H.2, e gjinisë F., i lindur me dt. ..., në f.sh.'T.', KK-P.1, tani me vendbanim në rr."R.G.", nr.1 P.2, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i ... fëmijëve, jo i punësuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**Konform nenit 363 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të KPPK-së,****REFUZOHET AKUZA**

SE: me datë 02.07.2014, rreth orës 16:00 h, pas një zënke që ka ndodh në pyllin e fshatit M.1, Komuna e P.1, në mes tij dhe të pandehurit R.H., ku më atë rast i pandehuri R.2 ka përdorë pushkën automatike të markës kallashnikov "AK-47", në mënyrë frikësuese dhe kërcënuese, i pandehuri G.M.me ndihmën e djalit të tij B.2 prezent në vendin e ngjarjës kanë arrit që të pandehurit R.2 t'ia heqin armën nga dora, e më pas të njëjtën armë e dërgon në shtëpinë e tij në fshatin "T." Komuna e P.1, e mban disa orë pa autorizim dhe për rastin nuk e njofton fare policinë, ndërkaq pushka automatike i sekuestrohet nga zyrtarët policorë në shtëpinë e tij pasi i pandehuri, të njëjtën ditë njofton zyrtarët policorë kur djali i vëllaut të të pandehurit R.2 e godet me veturë,-

- me çka kishte për të kryer veprën penale: Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK-së.

Për shkak se Prokurori i shtetit, është tërhequr nga aktakuza në shqyrtimin gjyqësor.

Për të akuzuarin G.M., shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti për krime të rënda, me aktakuzën PP.nr.699/2014 të datës 30.07.2014, ka akuzuar B.H.për shkak të veprës penale Vrasje në tentativë nga neni 178, lidhur me nenin 28 të KPK-së, R.2 Halilaj për shkak të veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPK-së, dhe G.M.për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK-së.

Në këtë çështje penale gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar, dhe pasiqë të akuzuarit janë njoftuar me të drejtat e tyre në kuptim të nenit 323 par.1 dhe 2 të KPPK-së dhe pas leximit të aktakuzësi, akuzuari R.H. e ka pranuar fajësinë, për veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPK-së, ndërsa të akuzuarit B.H.dhe G.M.nuk e kanë pranuar fajësinë dhe meqenëse të njëjtit nuk e kanë pranuar fajësinë lidhur me veprat penale për të cilat akuzohen, Gjykata duke u bazuar në nenin 327 të KPPK-së, ka vendosur që seanca e shqyrtimit gjyqësor të vazhdojë me fjalën hyrëse dhe prezantimin e provave.

Prokurori i çështjes Armend Hamiti në fjalën përfundimtare të dorëzuar në formë të shkruar dhe të elaboruar gojarisht, ka deklaruar se nga të gjitha provat e administruara siç janë dëshmitë e dëshmitarve B.M., A.M. dhe I.M. si dhe nga provat materiale është vërtetuar që të akuzuarit B.H.dhe R.H. kanë kryer veprat penale për kryerjen e të cilave janë akuzuar, andaj lidhur me të njëjtit nga gjykata ka kërkuar që të shpallen fajtorë edhe të dënohen sipas ligjit. Ndërsa që ka theksuar se nga provat e administruar nuk është vërtetuar se i akuzuarri G.M.ka kryer veprën penale të përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës, andaj lidhur me të njëtin ka hequr dorë nga aktakuza.

I dëmtuari B.M. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në tërësi e përkrah fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit dhe njëherit parashtron kërkesë pasurore juridike.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.H.av. M.H. në fjalën përfundimtare të dorëzuar në formë të shkruar e të elaboruar në pika të shkurta gojarisht , ka deklaruar se nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është vërtetuar se i mbrojturi i tij B.H.ka kryer veprën penale për kryerjen e të cilës është akuzuar, pasi që nuk është kontestuese se i njëjti e ka goditur me veturë të dëmtuarin G.M.mirëpo që goditja ka ardhur si rezultat i pakujdesisë dhe mungesës së përvojës të të mbrojturit të tij në drejtimin e automjetit dhe se kjo vërtetohet edhe nga fakti se sikur të ekzistonte dashja për ta privuar nga jeta tani të dëmtuarin G.M.atëherë goditja me veturë do të ndodhte drejtëpërdrejtë në pjesën ballore të veturës , e jo në pjesën anësore siç ka ndodhur realisht. Andaj, i ka kërkuar gjykatës që të bëjë rikualifikimin e veprës penale nga vrasje në tëntativë në veprën penale shkaktim i rrezikut të përgjithshëm dhe me këtë rast si rrethanë lehtësuese të marrë faktin se marrëdhëniet ndërmjet tyre janë rregulluar dhe nuk ka pasur probleme tjera , se i mbrojturi i tij është mbajtës i familjës dhe jeton në kushte të vështira ekonomike.

I akuzuari B.H.në fjalën përfundimtare në tërësi e ka përkrahë fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij.

Mbrojtësja e të akuzuarit R. H., av.E.V.-Sh. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pasi që i mbrojturi i saj e ka pranuar fajsinë dhe është penduar për veprimet e tij, të njëjtat të merren si rrethana lehtësuese bashkë me rrethanën që tani më ka ndodhur pajtimi me familjën e të dëmtuarit dhe se është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin. Andaj ka kërkuar nga gjykata që ndaj të mbrojturit të tij të shqiptojë një dënim sa më të butë, përfshirë edhe një dënim të kushtëzuar.

I akuzuari R.H. në fjalën përfundimtare në tërësi e ka përkrah fjalën përfundimtare të mbrojtëses së tij.

Gjykata pas vlerësimit të provave të proceduara një nga një dhe të gjithave së bashku ka vërtetuar gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjendja faktike në këtë çështje penale është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë në bazë të deklaratave të dëshmitarëve B.M., A.M. dhe I.M. si dhe provave materiale:vërtetimi mbi marrjen e përkohshme të veturës dhe qelsave me nr. 214-AF-0792 të dt.03.07.2014, zingjiri ruajtjes së armës, karikatorit dhe fishekët me nr. 214-AF-0792 të dt.03.07.2014, lista e provave materiale e dt:03.07.2014 si dhe fotodokumentacioni që ndodhet në shkresat e lëndës, si dhe nw bazw tw deklaratave tw akuzuarve qe janw marw si provw .

**Dëshmitari/i dëmtuari B.M.** në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se derisa ka qenë duke punuar në mal së bashku me babën G.M. dhe djali i mixhës Z.M. dhe një puntorë, ka ardhur tani i akuzuari R.2 me një arme të zjarrit në krah, dhe i është drejtuar me fjalët “pse po punon këtu” ndërsa që dëshmitari e ka ftuar që të bisedojn, i njëjti ka refuzuar dhe pasi që babai i dëshmitarit e ka dëgjuar bisedën, ka shkuar dhe e ka “zaptu R.2 me duart e veta”, ndërsa që dëshmitari ja ka hjek armën nga dora të njëjtit, me ç’rast i njëjti është larguar, ndërkohë që atë kanë vazhduar për në shtëpin e tyre dhe ndërkohë babai i dëshmitarit ka dalur për të bler diçka në shitore dhe me atë rast është njoftuar nga vëllau D. se dikush e ka shkelur me veturw babain e tij, ndërsa që kur ka shkuar në vendin e ngjarjes e ka kuptuar se ka goditur me vetur djali i vëllaut të R.2, tani i akuzuari B.H., i cili është prezent në sallën e gjykimit. Në vendin e ngjarjes e ka parë policinw e cila ka qenë e pranishme, ndërsa që nuk i është kujtuar se kush e ka derguar babain e tij në spital, mirëpo ka thëksuar se në spital ka qëndruar një natë. Më tutje ka shtuar se para kësaj ngjarje, nuk kanë pasur ndonjë mosmarrëveshje me tani të akuzuarit, ndërsa që ka parashtruar edhe kërkesë pasuroro-juridike duke e konsideruar vetwn si palw tw demtuar Poashtu edhe në deklaratat që ky dëshmitar ka dhënë në procedurën paraprake, gjegjësisht deklaratën e dhënë në polici me dt.03.07.2014 dhe në Prokurori me dt.17.07.2014 në mënyrë të ngjajshme ka përshkuar ngjarjën e ndodhur në ditën kritikë, përfshirw momentin kur i akuzuari R.2 ka ardhur në mal më një armë në krah, ani pse në këtë deklaratw ka pohuar se arma të cilën e ka pasur i njëjti ka qenë e tipit kallashnikov dhe se të njëjten ja drejtuar tani dëshmitarit, ndërsa që babai i dëshmitarit ka arritur të ja heq nga dora dhe se këtë armë e kanë marrur dhe e kanë dërguar në shtëpi dhe meqenëse ka qenë koha e iftarit, kanë vendosur që pas iftarit ta lajmërojnë rastin në polici.

**Dëshmitari A.M.** në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se derisa ka qenë duke ecur rrugës së fshatit afër një gurthyesi, rreth orës 18:00 ne një largwsi prej dy apo tre metrave e ka pa një veturë të ndalur të tipit Golf 2 me ngjyrë të kuqe, dhe në atë veturë i ulur në ulësen e vozitësit ishte N.H. , vëllau i B.H., dhe pasi që ka arritur në shtëpi e ka kuptuar se se Çka i ka ndodhur axhës së tij G., dhe madje ju ka treguar që e ka pa një veturë golf 2 me në rrugën e fshatit. Më tutje ka theksuar se me tani të akuzuarit nuk kanë pasur probleme të më hershme, janë përshendetur por nuk kanë pasur raporte të më tejme. po ashtu edhe në deklaratën e dhënë në prokurori me dt.16.07.2014 është deklaruar ngjajshëm lidhur me rrethanën që derisa ka qenë duke ecur në rrugën e fshatit, ka parë në vetur të ndalur e tipit Golf II dhe se në vetur ka qenë N.H., djali i vëllaut të tani të akuzuarit R.H..

**Dëshmitari I.M.**, në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se në natën kritikë dikun rreth orës 22:00 – 22:30 deri sa ka qenë duke qëndruar në një shitore bashkë me pronarin e të njëjtës L.S., ka vërejtur se si për një moment një veturë “Golf 2 “ me ngjyrë të kuqe me shpejtësi ka dalur në anën tjetër të rrugës- në drejtim të fshatit L.1 dhe ka goditur një person dhe në atë moment ai së bashku me L.2 janë afruar për ta ndihmuar personit të goditur i cili ka qenë i shtrirë në tokë, rrobat i ka pasur të shqyera dhe ka qenë i trulluar, dhe me atë rast i’a kanë dhënë telefonin që ta lajmëroj policinë, ndërsa që personi i cili ka vozitur veturën “Golf” ka vazhduar rrugën dhe nuk është ndalur, ndërsa që pas ballafaqimit me deklaratën e dhënë në prokurori ku kishte deklaruar se “voztësi i veturës ka qëndruar për një moment, e ka shikuar se çka u bë me G.” është përgjigjur se mbetet pranë asaj që ka thënë në prokurori. Po ashtu edhe në deklaratat që ka dhënë në procedurë paraprake, gjegjësisht në deklaratat të dhëna në polici me dt: 02.07.2014 dhe në prokurori

me dt: 17.07.2014 ka përshkruar në mënyrë të ngjashme dinamikën e ngjarjeve në natën kritike, ashtu që ka deklaruar se si rreth orës 22:15 deri s aka qenë në shitore e cila gjendej në hyrje të rrugës “H.T.” afër udhëkryqit në rrugën “R.G.” e ka parë se si një veturë ka dalur në drejtimin e kundërt pra në anën e majtë dhe e ka goditur një person i cili ishte duke ecur në atë anë të rrugës vetura është ndalur për një moment, ka shikuar se çfarë është bërë me të dëmtuarin G. dhe me shpejtësi është larguar nga vendi i ngjarjes.

Nga vërtetimi mbi marrjen e përkohshme të veturës dhe qelsave me nr. 214-AF-0792 të dt.03.07.2014, vërtetohet se personi N.H. janë marrur vetura Golf II ngjyrë e kuqe me nr. ..., Qelsat e veturës dhe VRD nr....

Nga zingjiri ruajtjes së armës, karikatorit dhe fishekët me nr. 214-AF-0792 të dt.03.07.2014, vërtetohet se është sekuestruar një armë AK-47 e shkurtër, 1 karikator dhe 28 fishek të kal.7.62 mm, libeza e veturës ... (golf 2 ngjyrë e kuqe tar....), si dhe qelsat e veturës.

Nga lista e provave materiale e dt.03.07.2014 vërtetohet se tani të akuzuarit G.M.i është sekuestruar një armë AK-47 e shkurtër, 1 karikator dhe 28 fishek të kal.7.62 mm.

Nga fotodokumentacioni që ndodhet në shkresat e lëndës i dt.03.07.2014 vërtetohet se në të njëjtit janë paraqitur arma e cila është gjetur në shtëpin e tani të akuzuarit G.M.dhe po ashtu vendi ku është goditur tani i akuzuari G., në të cilin vend evidentohet edhe një telefon celular, ndërsa që kohë është errësir.

**I akuzuari B.H.në** seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se ditën kritike ka qenë në Podujevë, dhe se lidhur me mosmarrëveshjen që ka ndodhur në mes R.2 me G. e ka kuptuar nga kushëriri S.H., dhe me atë rast ka vendosur të shkoj të tani i akuzuari G. me qëllim që ta kuptoj për rastin që ka ndodhur dhe se gjatë rrugës e ka parë G. duke e kaluar rrugën, dhe duke dashur të leviz mbrapa me qëllim që të kthehet me veturën e tij e ka prek me anën e majtë të veturës, zhurëm nuk ka dëgjur, pastaj duke u frikësuar se mos po ndodh më e keqja, ka vazhdu rrugën, nuk është ndalur, dhe e ka shkuar në shtëpinë tij, ndërsa që pas ballafaqimit me pjesën e deklaratës së dhënë në prokurori me dt... ku kishte deklaruar se “atje kam shku me veturën e markës golf II, i jam afru shtëpisë së G. rreth 50 metra, e kam vërejt G. duke ecur rrugës në asfalt, jam afru me ja ba me dije se dëshiroj me bisedu me të, por kur është afru, meqenëse unë kam qenë në veturë G. në këmbë kam mendu se po më frikëson G., pastaj kam shku rikferc për me ndërru drejtimin e veturës, pastaj e kam prek G., i cili ka fillu të më shajë, kur e kam godit e kam pa se ka rrëshqit, por nuk e kam pa se është rrëzu në tokë”, është përgjigjur se e vërteta është ajo që deklaroj sot, Ndërsa që po ashtu është ballafaqur me deklaratën e dhënë në polici dt.11.07.2014 ku lidhur me momentin kritik ka deklaruar se “ posa kam hy në rrugën që shkon tek shtëpia e G. e kam vërejt se G. vinte nga drejtimi i kundërt, posa jam afruar G., ai nuk është ndalur, atëherw unë kam dashur që ta vozisw veturën mbrapa dhe posa kam lëvizur pak mbrapa dhe kam dashur ta kthej veturën në drejtim kah lëvizte G., atëherw me pjesën e përparme të veturës me krillën e majtë të rrotës së parë e kam goditur G. pa qëllim, ku kam dëgjuar se G. ka bërtitur dhe ka fillu që të më ofendoj. Unë jam frikësu dhe kam ikë nga vendi i ngjarjes dhe kam shku në shtëpi”, përÇka është përgjigjur se ai nuk ka bërtit nuk ka thën asgjë. Më tutje ka shtuar se pasi që e ka kuptuar se e ka goditur me vetur G., të njëjtit i ka kërkuar falje, e të cilin kërkim falje i njëjti e ka pranuar me çka edhe ka ndodhur pajtimi ndërmjet tyre.

Gjykata e ka vlerësuar dëshmin e dëshmitarit Isak Mehmeti, dëshmi të cilës i ka fal besimin pasi që e njëjta është e sinqert, reale dhe objektive e nga e cila dëshmi vërtetohet bindshëm fakti se tani i akuzuari B.H., pasi që e ka vërejtë duke ecur rrugës të dëmtuarin G., fillimisht ka ndalur makinën e markës “Golf II”, ngjyrë e kuqe, e më pas është nisur me shpejtësi dhe ka dalur në anën tjetër të rrugës ku ishte duke ecur tani i dëmtuari G. dhe e ka goditur me vetur dhe pastaj ka vazhduar rrugën duke mos u ndalur. Në deklaratat që ky dëshmitar ka dhënë në procedurë paraprake gjegjësisht në deklarata polici me dt: 02.07.2014 dhe në prokurori me dt: 17.07.2014 e po ashtu edhe në dëshminë në shqyrtim gjyqësor në mënyrë të ngjajshme ka përshkruar dinamiken e ngjarjes në momentin kritik, përkatësisht shpjetësin e veturës, daljen në anën tjetër të rrugës dhe goditjen e personit gjegjësisht të tani të dëmtuarit G. M., dhe pastaj largimin e personi me veturë nga vendi i ngjarjes.

Gjykata ka vlerësuar edhe dëshmit e dëshmitarve B.M.dhe A.M., e te cila dëshmi i ka gjetur si dëshmi të sinqerta dhe objektive, e nga të cilat dëshmi po ashtu vërtetohet bindshëm fakti se të akuzuarit B.H.dhe R.H., kanë kryer veprat penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, mirëpo sa i përket dëshmisë së dëshmitarit B.M., tani i akuzuari R.H. e kanë pranuar kryerjen e veprës penale pra që që deri sa i dëmtuari G. së bashku me djalin e tij B.2, djalin e vëllaut Z.1 dhe punëtorin A.M., kanë qenë duke prerë dru në vendin e quajtur “B.3”, i’u është afru atyre me armë në dorë, pushkën automatike kallashnikov, të markës “AK-47”, duke ju thënë “pse po punon këtu” pikërisht siç e ka përshkruar ky dëshmitar. Ndërsa që sa i përket dëshmisë së dëshmitarit A.M., edhe vetë i akuzuari B.H.e ka pohuar faktin se tani i akuzuari R.H. është axha i tij, dhe që siç ka pohuar edhe vetë pasi që ka dëgjuar për këtë ngjarje, është nisur për të shkuar te tani i dëmtuari G., pra edhe vetë i akuzuari B.1, e ka konfirmuar faktin se në natën kritike ka qenë me veturën e markës Golf II, mirëpo që sipas tij kinëse është nisur për të shkuar me qëllim për të biseduar lidhur me ngjarjen, pra kjo rrethanë nuk është kontestues as për vetë të akuzuarin B.1.

Gjykata po ashtu ka vlerësuar edhe vërtetimi mbi marrjen e përkohshme të veturës dhe qelsave me nr. 214-AF-0792 të dt.03.07.2014, zingjiri ruajtës së armës, karikatori dhe fishekët me nr.214-AF-0792 të dt.03.07.2014, lista e provave materiale e dt:03.07.2014 si dhe fotodokumentacioni që ndodhet në shkresat e lëndës, e nga të cilat ka vërtetuar po ashtu bindshëm gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata pas vlerësimit të të gjitha provave të administruara në shqyrtim gjyqësor ka vlerësuar se në veprimet e tani të akuzuarve B.H.dhe R.H. ekzistojnë të gjitha elementet e veprave penale si në pjesën fjaësuese të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Sa i përket të akuzuarit B.H., Gjykata vlerëson se në veprimet e tij manifestohen të gjitha elementet e veprës penale vrasje mbetur në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, pasi që pakontestueshëm është vërtetuar fakti se i njëjti e ka goditur me veturë tani të dëmtuarit G.M., fakt ky i pranuar edhe vetë nga vetë i akuzuar B.1, ndërsa fakti që i njëjti e ka goditur me qëllim që ta privoj nga jeta vërtetohet veprimet e të akuzuarit B.1 në momentin kritik, por edhe gjithë rrjedhja e ngjarjes dhe motivi që e ka shtyre të akuzuarin B.1 të veprojë në këtë mënyrë, ashtu që bindshëm është vërtetuar fakti se fillimisht i njëjti me veturën e markës Golf II ka qenë ndalur, dhe pastaj pasi që ka vërejtur të akuzuarin G., është nisur me shpejtësi, ka dalur në anën tjetër të rrugës dhe ka goditur të njëjtin, ndërsa që bazuar në natyrën e lëndimeve nga goditja e pësuar, i akuzuari G.

është goditur në pjesën e përparëme të trupit, me ç'rast edhe ka marrur lëndime të lehta trupore, ndërsa që nisur nga vendet e lëndimeve të pësuar, të njëjtat kanë mundur të rezultojnë vdekjeprurëse për të akuzuarin G.M., e po ashtu mjete me të cilin është goditur i njëjti që është vetura, e njëjta wshtw e përshtatshme për shkaktimin e lëndimeve të rënda gjegjësisht privimin nga jeta nëse me të njëjtin personi goditet në pjeset vitale të tij siq edhe ka ndodhur me tani të akuzuarin tani të dëmtuarin G.M.. Pra nga të gjitha provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor, është provuar se i akuzuari B.H.ka pasur si qëllim dhe ka dashur ta privoj nga jeta tani të akuzuarin G.M..

Ndërkaq sa i përket të akuzuarit R.H., meqë i akuzuari në prezencë dhe pas konsultimeve me mbrojtësen e tij, e ka pranuar fajësinë në tërësi për kryerjen e veprës penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për kryerjen e veprës penale, pranim i cili është bërë vullnetarisht, pranim i cili mbështetet në faktet e çështjes dhe provat materiale që përmban aktakuza, dhe se nuk përmban asnjë shkëlqje ligjore apo gabim faktik, Gjykata vlerësoj se janë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore nga neni 248 të KPPRK-së, që të pranohet deklarata e të akuzuarit për pranimin e fajësisë për kryerjen e kësaj vepre penale, dhe të njëjtin edhe e ka aprovuar, duke mos administruar asnjë provë lidhur me vërtetësinë e gjendjes faktike. Prokurori nuk ka pas vërejtje në deklaratën e të akuzuarit për pranimin e fajësisë.

Sa i përket të akuzuarit G.M., prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare është terhequr nga ndjekja penale kur këtij të akzuarit, me arsyetimin se nga provat e administruara nuk është vërtetuar se i njëjti ka kryer veprën penale për kryerjen e të cilës është akuzuar, andaj gjykata në zbatim të dispozitave ligjore nga neni 363 par.1 nënpar.1.1 të KPRK-së, ka nxjerr aktgjykim refuzues.

Gjykata ka vlerësuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit B.H.mirëpo të njëjten e ka vlerësuar të pabazuar e në kundërshtim me provat e administruara në këtë çështje penale dhe më qëllim të ikjës nga përgjegjësia penale për veprën penale për të cilën është akuzuar. Pretendimi i mbrojtjes se i akuzuarit B.1 e ka goditur pa dashje të akuzuarin G., gjegjësisht në momentin kur ka dashur të leviz pas me qëllim që të bisedoj me të njëjtin lidhur me mosmarrëveshje qw tani i dwmtuari G. kishte pasur me herët me axhen e të akuzuarin H.3, tani të akuzuarin R.H., është pretendim tërësisht i pa bazuar, duke qenë se vetë i akuzuari në mbrojtjen e tij, ka dhënë versione të ndryshme lidhur me zhvillimin e ngjarjes në momentin kritik e që të gjitha të karakterizuara nga një munges logjike në shpjegimin e veprimeve të tij në ato momente, ashtu që ka pretenduar se ka shkuar për të biseduar me G., lidhur me ngjarjen ku ishte përfshirw axha i tij tani i akuzuarit R.H., mirëpo kur është afruar G., ky i akuzuar është larguar pasi që është frikësuar prej tij, ani pse nuk ka treguar se pse është larguar, duke qenë se nuk ka përmendur se ka parë diçka në duart e G., që do përbënte shkas për friksim nga i njëjti, edhe pse në deklaratat e dhëna në procedurën paraparake ka pretenduar se është sharë nga G., mirëpo pasi që siq ka pretenduar pa qëllim e ka goditur me vetur të njëjtin, ndërkaq që në mbrojtjen e paraqitur në shqyrtim gjyqësor nuk e ka përmendur faktin e pretenduar se është shara nga G., ndërkaq që nuk ka dhënë kurrfarw arsye për këtë ndryshim në përkrahimin e rrethanave të ngjarjes. Po ashtu, pretendimi i të akuzuarit B.1 është në kundërshtim edhe me dëshmin e dëshmitarit A.M. i cili i cili ka përkrahur bindshëm veprimet e tani të akuzuarit B.1 në natën kritike, ashtu që pasi që i njëjti pasi ka qenë i ndalur me veturë, kur e ka vërtetuar tani të të akuzuarin G., është nisur me shpejtësi, ka dalur në anën tjetër të



rrugës dhe e ka goditur të njëjtin dhe pastaj është larguar, e po ashtu është në kundërshtim natyrën dhe lokacionin e lëndimeve të pësura nga i dëmtuari G., që është e qart që nuk mund të jenë rrjedhojë e një prekje me veturë apo “me krillën e majtë të rrotës së pare” siq ka pretenduar ky i akuzuar. Gjithashtu mbrojtja e të akuzuarit është në kundërshtime dhe me rrjedhën logjike të ngjarjes dhe vetë veprimeve të të akuzuarit pasi që në rast se siq ka pretenduar i akuzuari se prekja ka qenë e paqellimshme, atëherë është dashur që i njëjti në ndalet, të interesohet për gjendjen e tani të dëmtuarit G. dhe të i ofroj ndihmen e nevojshme nga ana e tij dhe jo të largohet me shpejtësi nga vendi i ngjarjes siq ka vepruar në natën kritike.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së sanksionit penal gjykata në raport me të gjithë këta të akuzuar , si rrethana lehtësuese ka marr faktet që të njëjtit nuk kanë qenë më parë të gjykuar apo dënuar për vepra penale, sjelljen e tyre pas kryerjes se veprës penale, siq është pajtimi me palën e dëmtuar, çka tregon se këta të akuzuar nuk janë delikuent të rrezikshëm, ndërsa që ngjarja është një zhvillim i izoluar në jetën e tyre, kohë e kaluar nga koha e kryerjes së veprave penale, po ashtu të njëjtit janë familjarë, mbajtës i familjes, ndërsa që si rrethana veqanarish lehtësuese të cilat i kanë mundësuar gjykata zbatimin e dispozitave për zbutjen e dënimit nga neni 75 i KPRK-së, që lidhur me të akuzuarin B.H.edhe lidhur me nenin 28 par.3 të KPRK-së që parashe mundësin e zbutjes së dënimit, e që gjykata vlerëson se për një zbutje të tillë ekzistojnë rrethanat në rastin konkret, duke pasur parasysh pasojat e shkaktuara me veprën penale, gjegjësisht se i dëmtuar G. ka pësuar vetëm lëndime të lehta trupore dhe po ashtu mos manifestimin e të akuzuarit B.1 të një këmbgulje në kryerjen e veprës penale, e që rezulton nga largimi i tij i menjëhershëm nga vendi i ngjarjes, ndërkaq që për të akuzuarin R.H. edhe pranimin e fajit për kryerjen e veprës penale, si dhe moshën e tij që është 1 moshës shtadhjetvjeçar . Andaj, në rastin konkret gjykata bazuar në rrethanat e mësipërme, të njëjtëve ua shqiptoj sanksionet penal përkatës si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se ky sanksione penale janë në përputhshmëri të plotë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të këtyre veprave penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarve dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikoj në riedukimin, risocializimin dhe parandalimin e të akuzuarve dhe personave tjerë nga kryerja e veprave penale në të ardhmen me çka edhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm dhe i veçantë i dënimit, konform nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi llogaritjen e arrest shtëpiak për të akuzuarin R.H. në dënimin e shqiptuar është marrur konform nenit 83 par.1 të KPRK-së.

Vendimi që të dëmtuarit G.M.dhe B.M.të udhëzohen në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore - juridike është marr konform nenit 463 par.2 të KPPK-së.

Vendimi që të akuzuarit janë obliguar që të paguajë gjykatës në emër të paushallit gjyqësorë si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës penale është marr në bazë të nenit 450 par.2 pika 2.6 të KPPK-së duke pasur parasysh kohëzgjatjen e procedurës penale si dhe gjendjen pasurore të akuzuarëve, ndërsa që lidhur me të akuzuarin G.M.vendimi lidhur me shpenzimet është marrur konform nenit 454 par.1 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**PKR.nr.418/14, të dt.16.07.2018**

**Kryetarja e trupit gjykues-gjyqtarja  
Shadije Gërguri**

**Bashkëpuntori profesional  
Driton Berisha**

**KESHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 /pesëmbëdhjetë/ ditë nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj Gjykate.